



# BULETINI

Qershor 2009

Numri 6/2009

## Përmbajtja

- Tryezë diskutimesh-penale: Ekzekutimi i dënimit me burg
- Tryezë diskutimesh-civile: Mjetet e jashtëzakonshme juridike-propozimi për përsëritjen e procedurës
- Seminar-civile: Ndërmjetësimi dhe pajtimi gjyqësor
- Kodi i Etikës ( Trajnim i avancuar) Regjioni i Prizrenit IGJK & NCSC
- Tryezë diskutimesh-penale: Parashkrimi i ndjekjes penale dhe ekzekutimit të dënimit
- Tryezë diskutimesh: Masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurë
- Trajnim i avancuar: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
- Trajnimi i Trajnuesve, aftësitë trajnuese mbi shkathtësitë gjyqësore NITA- New York
- Seminar: Ligji për Konkurrencën
- Tryezë pune- penale: Aspektet kryesore të shqyrtimit gjyqësor
- Sesion trajnues: Ndërtimi i shkathtësive të gjyqësorit IGJK & NITA
- Tryezë në nivel ekspertësh: Ligji për Procedurën Përmbartimore
- Trajnim i avancuar për gjyqtarët porotë
- Programi fillestar për arsimim ligjor
- Provimi përgatitor/hyrës për gjyqtarë dhe prokuror

ZHVILLIM  
PROFESIONAL  
GJYQËSOR

## Tryezë diskutimesh-penale: Ekzekutimi i dënimit me burg



e ekzekutimit të dënimit me burg si dhe rastet e vendosjes lidhur me kërkesën për shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit me burg. Gjatë këtij sesiioni trajnues janë analizuar ekzekutimi i dënimit me burg për të mitur dhe për të rritur. Në diskutim të këtyre çështjeve u bë një vështrim i problemeve të cilat shfaqen në praktikën gjyqësore me qëllim të unifikimit të sajë.

Më 2 qershor 2009, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka realizuar tryezën e diskutimeve me temë: **Ekzekutimi i dënimit me burgim**. Çështjet të cilat u diskutuan gjatë këtij trajnimi kryesisht u përqendruan në fillimin e

Përfitues të trajnimit ishin: gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha regjioneve të Kosovës.

## Tryezë diskutimesh-civile: Mjetet e jashtëzakonshme juridike-propozimi për përsëritjen e procedurës



Temat të cilat u shtjelluan gjatë punës së kësaj tryeze u përqendruan në çështjet që kanë të bëjnë me risitë e LPK-së lidhur me mjetet e jashtëzakonshme juridike, duke trajtuar veçmas Propozimin për Përsëritjen e Procedurës. Vëmendje e veçantë iu kushtua vështirësive me të cilat po ballafaqohen gjyqtarët në zbatimin praktik të dispozitave të reja ligjore të LPK-së lidhur me mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Instituti Gjyqësor i Kosovës me datën 04 qershor 2009 ka organizuar një tryezë të diskutimeve nga e drejta civile.

Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarët e lëmin civile të gjitha regjioneve të Kosovës.

## Seminar-civile: Ndërmjetësimi dhe pajtimi gjyqësor

Më 09 qershor 2009, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka organizuar seminarin nga e drejta civile me temë: **”Ndërmjetësimi dhe pajtimi gjyqësor”**.

Temat të cilat u shtjelluan gjatë punës së këtij seminary u përqendruan në çështjet që kanë të bëjnë me: Ligjin për Ndërmjetësimin, karakteristikat e arritjes së marrëveshjes në zgjidhjen e çështjeve civile (Ujdia Gjyqësore), përparësitë e ndërmjetësimit dhe pajtimit gjyqësor. Vëmendje e veçantë iu kushtua sqarimit të dispozitave të këtij ligji me të cilat do të ballafaqohen gjyqtarët me rastin e zbatimit në praktik mbi ndërmjetësimin.

Përfitues të këtij seminary ishin gjyqtarët e lëmis civile të gjitha regjioneve të Kosovës.



## Kodi i Etikës ( Trajnim i avancuar)- Regjioni i Prizrenit - IGJK & NCSC



### gjykatës dhe e prokurorisë në Kosovë.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët dhe prokurorët pjesëmarrës të jenë në gjendje të analizojnë në thelb dhe të bëjnë një interpretim më të gjerë të rregullave të etikës dhe mirësjelljes.

Përmes prezantimit të rasteve konkrete dhe situatave të vërteta të cilat u diskutuan në këtë trajnim u bë përpjekje të ngritët zhvillimi i shkathtësive specifike për njohjen dhe zgjidhjen e çështjeve të paanshmërisë dhe pavarësisë me rastin e marrjes së vendimeve gjyqësore.

Po ashtu objekt i trajtimit ishte edhe çështja e komunikimit me media nga ana e gjyqtarit apo prokurorit.

Instituti Gjyqësor i Kosovës më **11 qershor 2009** ka realizuar trajnim i avancuar me temë: **Etika e**

Përfitues të trajnimit ishin : gjyqtarë dhe prokurorë nga regjioni i Prizrenit.

## Tryezë diskutimesh-penale: Parashkrimi i ndjekjes penale dhe ekzekutimit të dënimit



Më 12 qershor 2009, në Institutin Gjyqësor të Kosovës, u realizua tryeza e diskutimeve me teme: **“Parashkrimi i ndjekjes penale dhe ekzekutimit të dënimit”**. Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan çështjet më të rëndësishme të cilat shfaqen në praktikën gjyqësore sa i përket parashkrimit të veprës penale. Trajnimin e përshkoj diskutimi interaktiv, komentet, pyetjet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve rreth çështjes së parashkrimit të ndjekjes penale, ekzekutimit të dënimeve, dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm.

Përfitues të trajnimit ishin : gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës.

## Tryezë diskutimesh: Masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurë



Më 16 qershor 2009, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka

realizuar tryezën e diskutimeve me temë “**Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale**”. Gjatë këtij sesioni trajnues u shtjelluan çështjet më të rëndësishme rreth disa masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale. Më konkretisht u analizuan dhe diskutuan çështjet rreth masës së arrestit shtëpiak dhe paraburgimit si masa të cilat mund të përdoren për të siguruar zbatim të suksesshëm të procedurës penale. Qëllimi i kësaj tryeze të diskutimeve ishte që përmes diskutimit dhe komenteve të rasteve praktike të sugjerohen zgjidhje të ndryshme që shkojnë në favor të harmonizimit të praktikës gjyqësore.

Përfitues të trajnimit ishin: gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës.

## Trajnim i avancuar: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut



Instituti Gjyqësor i Kosovës më datë 17 qershor 2009 ka mbajtur një seminar të nivelit të avancuar lidhur me

Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

Gjatë këtij seminari u trajtua struktura organizative, përbërja e Këshillit të Evropës dhe Gjykatës Evropiane, parimet dhe të drejtat e mbrojtura me Konvente si dhe zhvillimi i procedurës para Gjykatës Evropiane. Ndërkaq, në kuadër të dispozitave ligjore të konventës, u trajtua neni 5 paragrafi 4 dhe 5 dhe neni 6 paragrafi 1, 2 dhe 3. Me këtë rast, u prezantuan edhe raste të shumta nga praktika e Gjykatës Evropiane në lidhshmëri me dispozitat dhe temat e trajtuara në kuadër të këtij trajnimi.

Përfitues kryesor të këtij trajnimi ishin, prokurorë e gjyqtarë të të gjitha niveleve.

## Trajnim i trajnuesve, Aftësitë Trajnuese mbi shkathtësitë Gjyqësore NITA-New York

Më 11, 12 dhe 13 qershor 2009, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim dhe mbështetur nga Departamenti i Drejtësisë të SHBA-ve, Zyra Tejoqeanike OPDAT në Prishtinë, organizoi trajnimin e trajnuesve mbi zhvillimin e shkathtësive gjyqësore “NITA”. Trajnimi në fjalë u mbajt në New York.

Çështjet të cilat u trajtuan gjatë programit të lartcekur, kryesisht u përqendruan në demonstrimin e rasteve praktike përmes metodave të NITA-se të kritikimit, marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë dhe asaj të tërthorët

të dëshmitarëve, kundërshtimit të deklaratave dhe argumentimit përfundimtar. Qëllimi i këtij programi trajnues ishte aftësimi i pesë (5) prokurorëve vendor me njohuri të avancuara mbi shkathtësitë gjyqësore, të cilët pas çertifikimit nga Instituti në fjalë, fitojnë të drejtën për trajnimin e kolegëve të tyre mbi metodat e lartcekura, duke synuar themelimin e një praktikë unike mbi shkathtësitë avokuese në Kosovë.

## Seminar: Ligji për Konkurrencën - IGJK & BearingPoint



Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me BearingPoint me datën 18 dhe 19 qershor 2009 ka organizuar një seminar dy ditor me temë: “Ligji për Konkurrencën”. Qëllimi kryesor i këtij seminari ishte ofrimi i njohurive më të thella lidhur me Ligjin e ri për Konkurrencën dhe politikat e parapara në të. Një vëmendje e posaçme iu kushtua përputhshmërisë së këtij ligji me kërkesat kryesore të BE-së dhe atyre ndërkombëtare, si dhe realizimit të konkurrencës së drejtë në praktikë konform këtyre kërkesave. Me këtë rast u dhanë rekomandime të vlefshme për plotësimin dhe përmirësimin e këtij ligji për të ardhmen.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e lëmis civile të të gjitha regjioneve të Kosovës, gjyqtarët e Gjykatës Ekonomike si dhe bashkëpunëtorët profesional.

## Tryezë pune-penale: Aspektet kryesore të shqyrtimit gjyqësor

Instituti Gjyqësor i Kosovës më **22 dhe 23 qershor 2009** realizoi **tryezën e punës** me temë: **Aspektet kryesore të shqyrtimit gjyqësor**. Në kuadër të këtij sesiioni trajnues u bënë sqarime të dispozitave imperative të cilat vlejné gjatë kohës së përgatitjes së shqyrtimit gjyqësor dhe dispozitave të cilat e rregullojnë zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor. Më konkretisht u bë një analizim i detajuar i çështjes së publicitetit të gjykimit dhe respektimi i saj në Kosovë, përgatitjeve të shqyrtimit gjyqësor, deklarimit të akuzuarit si dhe ndryshimi dhe zgjerimi i aktakuzës duke përfshirë drejtimin e shqyrtimit gjyqësor dhe prezantimin e provave në këtë fazë të procedurës. Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës.



## Sesion trajnues: Ndërtimi i shkathtësive të gjyqësorit - IGJK & NITA



Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë të SHBA-ve dhe Institutin Kombëtar të Avokimit gjatë Gjykimit (“NITA”) nga SHBA-të, me datë 23, 24 dhe 25

qershor 2009 ka mbajtur një sesionin trajnimit tre ditor, me temë “Ndërtimi i Shkathtësive të Gjyqësorit”. Qëllimi i këtij trajnimit ishte që pjesëmarrësit të njoftohen me qëllimin, strukturën dhe teknikat e marrjes në pyetje të dëshmitarit përmes përdorimit të teknikave bazë dhe të avancuara. Pjesëmarrësit përmes punës praktike në grupe aplikuan shkathtësitë e gjyqësorit në një rast të imagjinuar, të kualifikuar si vepër penale e dhunës familjare dhe të dhunimit. Ky trajnim u realizuar përmes luajtjes së roleve të prokurorit dhe avokatit me rastin e përgatitjes dhe aplikimit të pyetjeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta deri te argumentimi i fjalës përfundimtare me incizim filmik. Përfitues të trajnimit ishin prokurorët e të gjitha niveleve dhe avokatë nga regjione të ndryshme të Kosovës.

## Tryezë në nivel ekspertësh-Ligji për Procedurën Përmbaremore

Instituti Gjyqësor i Kosovës i përkrahur financiarisht nga UNDP-ja, me datën 25 dhe 26 qershor 2009 në Prizren ka mbajtur tryezën e diskutimeve në nivel ekspertësh nga e drejta civile me temë: **”RISITË NË LIGJIN PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE”**.

Temat të cilat u shtjelluan gjatë punës së kësaj tryeze u përqendruan në:

- Dallimet ndërmjet dispozitave të vjetra dhe atyre të reja të Ligjit për Procedurën Përmbaremore.
- Risitë e LPP-së lidhur me përmbaremin në pasurinë e paluajtshme.
- Propozimin për përmbaremin sipas LPP-së.
- Risitë e LPP-së lidhur me mjetet juridike.
- Dokumentin përmbaremin në procedurën përmbaremore.
- Kundër përmbaremin në procedurën përmbaremore

Vëmendja u përqendrua edhe në çështjen se si ti qasen gjykatësit zbatimit praktik të dispozitave të reja të LPP-së. Gjithashtu në fokus ishin edhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohen në praktikë gjyqtarët në zbatimin e dispozitave të reja ligjore mbi procedurën përmbaremore. Ekspertët e caktuar në këtë tryezë prezantuan kumtesat e tyre të veçanta në temat e caktuara dhe pas debatit të frytshëm dhe rekomandimeve në tryezë këto kumtesa u pasuruan edhe me rekomandimet që dolën nga kjo tryezë. Këto rekomandime do të publikohen nga IGJK-ja dhe do t’iu shërbejnë të gjithë gjyqtarëve si kontribut në zbatimin më të lehtë të dispozitave të reja ligjore.

## Trajnim i avancuar për gjyqtarë porotë



Më datë 30 qershor 2009, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka realizuar trajnimin e avancuar për gjyqtarët porotë .

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan aspektet praktike të funksionit dhe rolit të gjyqtarëve porotë në; zbatimin e Ligjit për Familjen, marrjen e vendimeve në procedurën penale për të rritur dhe për të mitur si dhe u shqyrtuan disa aspekte të veçanta rreth raportit të gjyqtarëve porotë me publikun sipas Kodit të Etikës për Gjyqtarë Porotë.

Përfituesit e këtij trajnimi ishin gjyqtarët porotë të regjionit të Gjilanit dhe Mitrovicës.

## Programi Fillestar për Arsimim Ligjor

Kandidatët potencial për gjyqtarë dhe prokurorë të cilët ndjekin trajnimet në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor gjatë muajit qershor kanë përfunduar trajnimet e parapara për fazën e dytë dhe iu janë nënshtruar provimit përkatës në secilin modul trajnues.

Gjatë kësaj faze kandidatët kanë ndjekur trajnimet në 22 module trajnuese. Trajnimet kanë qenë të organizuara ndaras për kandidatët për gjyqtarë dhe kandidatët për prokurorë.

Me përfundimin e kësaj faze shënohet edhe përfundimi i trajnimeve të kombinuara teorike dhe praktike, për të vazhduar më tej trajnimin në fazën e tretë.

Trajnimi është vijuar nga 30 kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë.



### Provimi përgatitor / hyrës për gjyqtarë dhe prokuror -13 qershor

Bazuar në përgjegjësitë ligjore, Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, u pajtuan që të hartohen, administrohen dhe vlerësohen dy lloje të provimeve.

Me qëllim të rregullimit të kësaj çështje, Këshilli Programor i IGJK-së aprovoi një strukturë specifike të provimit për dy kategori të kandidatëve.

**Provimi për kandidatët me 7 apo më shumë vite përvojë pune juridike**

Ky provim është mbajtur me datë 13 qershor 2009, në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (ish Akademia Policore) në Vushtrri.

Këtij provimi i janë nënshtruar 129 kandidatë. Provimi është mbajtur nën drejtimin e përgjithshëm, mbikëqyrjen dhe administrimin e IGJK-së.

Vlerësimi i provimit është kryer në ambientet e KPGJP-së në hapësira të veçanta me qasje të kufizuar me datën 15 dhe 16 qershor 2009.

### Provimi përgatitor / hyrës për gjyqtarë dhe prokuror –20 qershor



**Provimi për kandidatët me më pak se 7 vite përvojë pune juridike**

#### Dita A: Pjesa me shkrim e provimit

Provimi (Dita A: Pjesa me shkrim e provimit) për kandidatët me më pak se 7 vite përvojë pune juridike është mbajtur me datë 20 qershor 2009, në QKSPEZh në Vushtrri. Këtij provimi i janë nënshtruar 196 kandidatë. Nga të gjithë këta kandidatë 60 rezultatet më të larta u kualifikuan për t'iu nënshtruar provimit me gojë. Provimi me gojë (Dita B e provimit) është planifikuar të mbahet me datë 09 korrik 2009, në ndërtesën e IGJK-së.

E gjithë procedura e regjistrimit, administrimit, monitorimit, mbikëqyrjes, sekretit të provimit, vlerësimit është e përshkruar në Raportin për Organizim të Provimit Përgatitor/Hyrës.

Ky provim është monitoruar nga përfaqësues ndërkombëtarë të OSBE-së (LSMS), KPGJP-dhe NCSC-së.

**Adresa: Lagja e Spitalit, Rr. "Muharrem Fejza" p.n.  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel&fax: +381 (0) 38 512 069  
+381 (0) 38 512 081  
+381 (0) 38 512 095  
[www.kjijudicial.org](http://www.kjijudicial.org)  
[info@kjijudicial.org](mailto:info@kjijudicial.org)**